



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:130896

Datë: 09.03.2022

Numri i dokumentit: 02787944

P.nr.1411/21

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Shpresa Emra, në çështjen penale kundër të akuzuarve Personi përgjegjës i personit juridik- M.S. nga f.sh. Komuna e Prizrenit, për shkak se ka kryer veprën penale shmangia nga tatimi nga neni 307 par. 2 lidhur me par. 1 të KP dhe të akuzuarit personi juridik SHPK me përfaqësuesin e autorizuar F.S. nga f.sh. Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale shmangia nga tatimi nga neni 307 par. 2 lidhur me par. 1 të KP, duke vendosur sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, PP/Il.nr.972-9/21 e dt.08.12.2021 pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në prezencën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, Prokurorit Labinot Jetishi, të akuzuarës së parë personi përgjegjës i personit juridik- M.S. dhe mbrojtësit të saj av. A.A. dhe të akuzuarit të dytë personi juridik SHPK me përfaqësuesin e autorizuar F.S. dhe me mbrojtësin B.Sh. me datë 07.02.2022, publikisht mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

E akuzuara

M.S. si Personi përgjegjës i personit juridik Sh.P.K,.... nga i ati A. emri i nënës I. e vajzërisë Q. e lindur me datë në Prizren, me banim në Gjermani qe 20 vite, e martuar, nënë e dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme , me firmë afariste në Kosovë, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës , identifikohet me letërnjoftim me nr. personal me nr.tel.

I akuzuari

F.S. përfaqësuesin autorizuar i Personit juridik Sh.P.K nga i ati V. e ëma M. i lindur me dt. në Tuttlingen- Gjermani , me banim në f.sh. Komuna e Prizrenit, i martuar, babë i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën mesme, i gjendjes së mirë ekonomike, punon si përfaqësues i autorizuar i firmës Sh.P.K me përfaqësi në Prizren identifikohet me letërnjoftim me nr. personal me nr. telefoni

JANË FAJTOR

E akuzuara M.S. - person përgjegjës i personit juridik Sh.P.K.

I.Sepse në periudhën kohore prej vitit 2016 e deri në vitin 2019, në firmën e tyre Sh.P.K. e cila gjendet në Prizren, në rrugën “Meriman Jakupi” Bllok C3, Lokali 10, e pandehura si person përgjegjës të personit juridik me numër të biznesit 71318001, me nr. unik identifikues 810975120 dhe nr. fiskal 601683627, në të cilën e njëjta e ushtron hulumtimin e tregut dhe matjen e opinionit publik (sondazhet-call center) me qëllim që t’i fsheh apo t’i shmanget pagesës reale të tatimit, në kuadër të veprimtarisë afariste realizon të hyra duke mos deklaruar vlerën e bonuseve të punëtorëve në deklarata vjetore për Tatimin në të ardhurat e Korporatave siç përcaktohet edhe me ligj, duke bërë shmangie nga tatimi në shumë prej 44.893.17 €.

- Me këto veprime ka kryer veprën penale Shmangia nga tatimi nga neni 307 par. 2 lidhur me par. 1 të Kodit Penal të Kosovës nr. 06/L-074.

I akuzuari Fikret Sadiku si përfaqësues i autorizuar i personit juridik Sh.P.K.

II.Sepse në periudhën kohore prej vitit 2016 e deri në vitin 2019, në firmën e tyre Sh.P.K. e cila gjendet në Prizren, në rrugën “Meriman Jakupi” Bllok C3, Lokali 10 p.n, i pandehuri personi juridik i kësaj firme me numër të biznesit 71318001, me nr. unik identifikues 810975120 dhe nr. fiskal 601683627, në cilësi të personit juridik që ushtron hulumtimin e tregut dhe matjen e opinionit publik (sondazhet-call center) me qëllim që t’i fsheh apo t’i shmanget pagesës reale të tatimit, në kuadër të veprimtarisë afariste realizon të hyra duke mos deklaruar vlerën e bonuseve të punëtorëve në deklarata vjetore për Tatimin në të ardhurat e Korporatave siç përcaktohet edhe me ligj, duke bërë shmangie nga tatimi në shumë prej 44.893.17 €.

- Me këto veprime ka kryer veprën penale: Shmangia nga tatimi nga neni 307 par. 2 lidhur me par. 1 të Kodit Penal të Kosovës nr. 06/L-074.

Pranohet marrëveshja për pranimin e fajësisë PP/II.nr.972-9/21 e dt. 20.12.2021 e lidhur në mes të Prokurorit të shtetit pranë Prokurorisë Themelore në Prizren-Departamenti i përgjithshëm dhe të akuzuarës, person përgjegjës i personit juridik Sh.p.k., M.S. me mbrojtësin e saj të autorizuar av. A.A. si dhe të akuzuarit personin juridik Sh.p.k. me përfaqësuesin e autorizuar F.S. si dhe mbrojtësi i tij sipas autorizimit av. B.Sh.

Andaj gjykata në kuptim të dispozitave të nenit 7, 8, 9, 10, 38, 39, 40,42, 43, 44, 69, 70,71, të KP , lidhur me nenin 9 par.1 dhe 2 nënpar.2.2 dhe nenit 12 par.2 i Ligjit për përgjegjësinë e personave juridik për vepra penale nr. 04/L-030 dhe nenit 365 të KPP-së të akuzuarit i

GJYKON

Të akuzuarën **M.S.** si person përgjegjës i personit juridik Sh.p.k. për veprën penale si në dispozitiv I të këtij aktgjykimi i shqiptohet **DËNIMI ME BURGIM** në kohëzgjatje prej **5 (pesë) muajve** i cili dënim në bazë të nenit 44 të KPRK-së, me pëlqimin e të akuzuarës dhe mbrojtësit të saj i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumën prej **1.500 (njëmijë pesëqind)** euro si dhe **DËNIMIN ME GJOBË** në shumën prej **1.000 (njëmijë) euro**.

Konform nenit 76 të KPRK-së të akuzuarës M.S. i shqiptohet dënimi Unik me gjobë në shumën **prej 2.500 (dymijë e pesëqind) euro**, cili dënim do të paguhet në afat prej 15 ditësh pas marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Në rast se dënimi me gjobë nuk realizohet as detyrimisht, gjykata këtë dënim do t'ia zëvendësoj të akuzuarit me dënim me burgim duke llogaritur me nga 20 Euro për çdo ditë burgim.

Të akuzuarit F.S. si përfaqësuesin e autorizuar i personit juridik Sh.p.k. për veprën penale si nën dispozitiv II të këtij aktgjykimi i shqipton dënimin me **ME GJOBË** në shumën prej **5.000 (pesëmijë) euro** i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin e kushtëzimit prej **2 (dy) viteve** nuk kryen vepër të re penale.

E dëmtuara ATK nga Prizreni, për realizimin e kërkesës pronësoresh juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civilo juridik.

Obligohen të akuzuarit që secili veç e veç, që të paguajnë shpenzimet e gjykatës dhe atë në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 20 Euro dhe për Fondin e kompensimit të viktimave shumën prej 30€, të cilat duhet të paguhet në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria e Shtetit–Prokuroria Themelore në Prizren, ka parashtruar aktakuzë PP/II.nr.972-9/21 e dt. 08.12.2021, kundër të akuzuarit M.S. nga fsh. Komuna e Prizrenit si person përgjegjës i personit juridik Sh.p.k. për shkak se ka kryer veprën penale shmangia nga tatimi nga neni 307 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së dhe të akuzuarit F.S. nga f.sh. Komuna e Prizrenit, përfaqësuesin i autorizuar i personit juridik SHPK me për shkak të veprës penale shmangia nga tatimi nga neni 307 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Prokuroria Themelore në Prizren Departamenti përgjithshëm përkitazi me aktakuzë PP/II.nr.972-9/21 ka parashtruar edhe Marrëveshjen për pranimit të fajësisë e dt. 20.12.2021 të cilën e kanë arritur në mes të me të akuzuarës M.S. – si person përgjegjës i personit juridik Sh.p.k. me mbrojtësin e saj të autorizuar av. A.A. dhe F.S. përfaqësuesin e autorizuar të personit juridik Sh.p.k. me mbrojtësin e tij me autorizim av. B.Sh.

Në shqyrtimin e dt.07.02.2022 i mbajtur në këtë çështje penale lidhur me marrëveshjen e cekur më lart gjykata bazuar në nenin 233 të KPP-ës, ka vlerësuar marrëveshjen mbi pranimitin e fajësisë, i ka dëgjuar të akuzuarit ku ka konstatuar se pranimiti është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarve pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësit e tyre .

Gjyqtari gjykues konstaton se janë përmbushur të gjitha kushtet e parapara ligjore konform nenit 233 par. 18 i KPP-ës, andaj ka pranuar marrëveshjen mbi pranimitin e fajësisë dhe pas përfundimit të dëgjimit në seancë ka shqiptuar edhe dënimin në suazat e marrëveshjes në mes të palëve.

Andaj duke u bazuar në këto rrethana, gjykata të akuzuarave i shqiptoi sanksionet penale sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke konsideruar se sanksionet e shqiptuara i përgjigjen shkallës së përgjegjësisë penale juridike të tyre dhe se me këto sanksione do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jenë më të kujdesshëm dhe të përmbahen nga veprimet e tilla.

Gjykata vendimin mbi udhëzimin e të dëmtuarit në kontest të rregullt civil e mori në harmoni me nenin 463 të KPP-së.

Vendimi mbi pagesën e kompensimit për Fondin e Kompensimit të viktimave është marr në kuptim të nenit 6 dhe 39 par.3 pik.1 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensim të Viktimave të Krimit .

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale, gjykata e mori në kuptim të nenit 450, 451 dhe 453 të KPP-së

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL
P.nr.1411/21 me dt. 07.02.2022
2021:130896, 07.02.2022

Gjyqtari

Shpresa Emra

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.